



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 2 qershor 2011
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS TË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Mungoi: Ibrahim Makolli.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin për Shërbimet e Sigurisë Private,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin për Gjendjen Civile,
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim- amendamenteve për Projektligjin për Shërbimet e Sigurimeve Private

Kryetari – Ju i keni marrë propozim- amendamentet për Projektligjin për Shërbimet e Sigurimeve Private. Grupi punues e ka kryer punën e vet, a keni ndonjë vërejtje apo sugjerim? Fjalën ia jap referuesit, z. Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi – Ne, si grup punues, kemi punuar shumë. Në këtë projektligj grupi punues ka bërë një punë shumë të mirë. Janë marrë parasysh gjitha komentet e deputetëve që kanë diskutuar në seancë gjatë leximit të parë dhe në grup punues janë shqyrtuar dhe janë inkorporuar shumica e vërejtjeve, pa e rrezikuar natyrën e projektligjit. Mund t'u them që është një ndër projektligjet më të punuara të Komisionit, shpresoj të mos jetë kështu në të ardhmen, por deri më tani është ndër ma të punuarat. Ky projektligj, normal që s'mund të jetë i përkryer, sepse po të ishin ligjet e tjera që ndërlidhen me këtë projektligj, atëherë edhe ky do të ishte më i përkryer.

Fatmir Xhelili- Edhe unë pajtohem me z. Selimi, sepse është një projektligj që i përmbush obligimit për çka miratohet, i përcakton qartë të drejtat dhe obligimet e kompanive private, rregullon relacionet ministri – kompani private, prandaj mendoj së është i gatshëm për miratim.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e miratuan Raportin me amendamentet e Projektligjit për Shërbimet e Sigurimeve private.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim -amendamenteve për Projektligjin për Gjendjen Civile

Kryetari- Ne, po ashtu, sot e kemi për shqyrtim dhe miratim amendamentet e Projektligjit për Gjendjen Civile. Unë jam caktuar referues për këtë projektligj, por të them të drejtën më shumë është angazhuar z. Fatmir Xhelili andaj ja jap fjalën që ta paraqet punën e bërë.

Fatmir Xhelili- Grupi punues ka pasur një qasje serioze ndaj këtij projektligji dhe të gjitha vërejtjet janë trajtuar me kujdes, janë vlerësuar dhe janë inkorporuar ato të cilat nuk e prishin përmbajtjen e projektligjit. Projektligji i plotëson kriteret për të qenë i zbatueshëm. Ky projektligj i rregullon obligimet dhe detyrimet e agjencisë, të gjendjes civile, andaj propozoj që ky projektligj të shkoj në procedurë të mëtutjeshme.

Kryetari- Të ju njoftoj se dje ka ardhur një propozim nga MPB- ja që ka të bëjë me regjistrat, ku thuhet formën fizike dhe elektronike të regjistrave civilë, ndërsa ka të bëjë

me shpenzimet e varrimit, të përfshihet në projektligj, pra të rregullohen me akt nënligjor shpenzimet e varrimit.

Fatmir Xhelili- Pajtohem me propozimin e parë të MPB- së, ndërsa sa i përket propozimit të dytë unë e di se kjo do të jetë e vështirë për t'u realizuar duke pasur parasysh linjat buxhetore të MPB- së.

Kryetari- Sa i përket kostos buxhetore ne nuk mund t'i tejkalojmë ato për arsye se nuk e dimë dedikimin e financave të një ministrie, se sa mund t'i tejkaloj ato shpenzime.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e miratuan Raportin me amendamentet e Projektligjit për Gjendjen Civile, bashkë me propozimin e parë të MPB- së.

Goran Marinković- Unë kisha dashur ta di pse nuk jam ftuar në takimet e grupit të punës, sepse sa e di unë jam anëtar i pothuajse i të gjitha grupeve të punës dhe tani po e shoh që amendamentet janë kryer dhe unë nuk jam ftuar të marrë pjesë në këto grupe punuese. Prandaj ju kisha lutur që përderisa jam anëtar i një grupi punues, atëherë duhet të ftohem.

Kryetari- Ne ju kërkojmë falje nëse nuk jeni njoftuar dhe besoj se kjo nuk do të përsëritet më. Administrata e ka për obligim që të ju njoftojë dhe besoj se kjo nuk do të përsëritet më.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale

Kryetari- Javën e kaluar e kemi pasur në diskutim këtë propozim vendim, i keni parë emrat e kandidatëve, kemi pasur vërejtje në dy kandidat, z. Ramadan Qehaja për shkak të moshës dhe z. Mentor Hoxha, i cili nuk i ka 3 vjet përvojë pune. Jemi akorduar për konsultime shtesë, por nuk kemi arritur të bëjmë konsultime, andaj propozoj që kjo çështje të shtyhet prapë për një takim të radhës.

Anton Quni- Unë kisha propozuar që deri në takimin e radhës të dimë shumë për detyrat e punës së këtyre kandidatëve, pra për secilin të dimë se për cilën detyrë konkurron, po ashtu të njoftohemi mirë me organiken e kësaj Agjencie.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që shqyrtimi i Propozim–vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, të shtyhet për takimin e radhës.

5. Të ndryshme

Kryetari- Sa i përket kësaj pike nuk ka ndonjë çështje të rëndësishme, por ua kujtoj që ditën e hënë, më 6 qershor, do të mbahet një test i gjuhës angleze, në mënyrë që ta kem një rezultat se në çfarë niveli mund ta fillojmë kursin.

Çështja tjetër që dua t'ju njoftoj është udhëtimi për në Gjenevë. Ky udhëtim do të bëhet më 26 qershor, agjendën tash e keni marrë dhe për çdo ndryshim kërkoj nga përfaqësuesja e DCAF-it Luanda Domi që të na njoftojë me kohë.

Pasi që nuk kishte çështje të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoj në ora: 11:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi